

ORONDIS EVO 25/1.2 SC
PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE



TË RUHET NË VENDE TË SIGURTA DHE LARG FËMIJËVE

Lëndët vepruese: Azoxystrobin & Oxathiapiprolin

PËRMBAJTJA: Azoxystrobin 25 % p/v Oxathiapiprolin 1,2 % p/v Lëndë ndihmëse 75,2 % (p/p)

Formulimi: Koncentrat i suspendueshëm (SC).

Fungicid sistemik me veprim parambrojtës kundër sëmundjeve të ndryshme kërpudhore.

KUJDES

- **Shumë toksik për organizmat ujorë, me efekte afatgjata.**

MASA PARAMBROJTËSE

- Të ruhet në vende të sigurta dhe larg fëmijëve.
- Mos hani dhe mos pini lëngje e duhan gjatë përdorimit.
- Shmangni lëshimin në mjedis.
- Hidhni përmbajtjen/ kontejnerin në përputhje me legjislacionin kombëtar.
- Vishni uniformë të plotë mbrojtëse gjatë përzierjes/ngarkimit dhe gjatë trajtimit. Rekomandohet përdorimi i dorezave.
- Në rast të rifutjes në parcelën e trajtuar vishni uniformë mbrojtëse të gjithë trupit. Rekomandohet përdorimi i dorezave.

UDHËZIME PËR NDIHMËN E PARË DHE KËSHILLA PËR MJEKUN

- **Udhëzime të përgjithshme:** Të keni në dispozicion paketimin, etiketën ose MSDS e produktit në rast se kërkon ndihmë nga mjeku ose nga Qendra e Helmimeve.
 - **Në rast se merret me organet e frymëmarrjes:** Nxireni të aksidentuarin në ajër të pastër. Në rast të frymëmarrjes së parregullt ose ndërprerjes së frymëmarrjes, filloni frymëmarrjen artificiale. Lëreni viktimën të pushojë dhe mbajeni atë ngrohtë. Njoftoni menjëherë mjekun ose Qendrën e Helmimeve.
 - **Në rast kontakti me lëkurën:** Hiqni menjëherë rrobat e ndotura . Lani lëkurën menjëherë me ujë të bollshëm. Nëse acarimi i lëkurës vazhdon, konsultohuni me një mjek. Lani rrobat e ndotura përpara se ti vishni përsëri.
 - **Në rast kontakti me sytë:** Shpëlajini me kujdes me ujë për të paktën 15 minuta. Nëse ka lente kontakti, i hiqni ato nëse është e lehtë. Vazhdoni shpëlarjen. Kërkon ndihmë mjekësore.
 - **Në rast gëlltitje:** Thërrisni menjëherë Qendrën e Helmimeve ose mjekun dhe tregojini ambalazhin ose etiketën. Mos provokoni të vjella.
 - **ANTIDOTI:** Antidot specifik nuk njihet. Ndiqni trajtim simptomatik.
- Tel. Urgjence: 127**

I destinuar vetëm për përdoruesit profesionistë.

MOS NDOTNI UJRAT ME PREPARATIN OSE ME AMBALAZHIN E TIJ.

Mos lani pajisjet spërkatëse pranë ujrave sipërfaqësore. Shmangni ndotjen përmes sistemit të kullimit nga sipërfaqet e shtruara gurë dhe nga rrugët. .

Për të shmangur rreziqet për shëndetin e njeriut dhe për mjedisin, ndiqni me kujdes udhëzimet e përdorimit.

Përmban 1,2 benzisothiazol-3-one. Mund të shkaktojë reaksion alergjik.

Mënyra e veprimit:

Fungicid sistemik me veprim parambrojtës kundër sëmundjeve të ndryshme kërpudhore. Lënda vepruese azoxystrobin ka veprim sistemik dhe pjesërisht translaminar. Ajo pengon rritjen e micelit, prodhimin dhe mbirjen e sporeve, duke kontrolluar një gamë të gjerë kërpudhash. Në nivel biokimik, veprimi i saj është në kompleksin III të zinxhirit të frymëmarrjes.

Lënda vepruese oxathiapiprolin shfaq veprim sistemik lokal dhe lëviz në mënyrë translaminare përmes ksilemës. Ajo vepron si një rregullator i lidhjes së oksisterolit (OSBPI) në qelizat e kërpudhave, duke prishur funksionet qelizore si sinjalizimi, mirëmbajtja e membranave qelizore dhe formimi i lipideve të nevojshme për mbijetesën e kërpudhave.

Mënyra e përgatitjes së tretësirës spërkatëse:

Mbushni me ujë deri në mes pompën spërkatëse dhe filloni përzierjen. Hidhni dozën e duhur të preparatit duke vazhduar përzierjen dhe plotësoni pompën me sasinë tjetër të ujit duke e përzier vazhdimisht.

Pastrimi i pajisjeve spërkatëse:

Menjëherë pas përdorimit pastroni me kujdes pajisjet spërkatëse. Zbrazeni plotësisht rezervuarin. Shpëlajeni atë dhe të gjitha pjesët e pajisjes spërkatëse tre (3) herë me ujë të pastër, derisa shkuma dhe të gjitha gjurmët e produktit të jenë zhdukur plotësisht.

Përdorimi (kulturat bujqësore, objekti i luftimit, dozat, mënyra dhe koha e trajtimit, numri maksimal i trajtimeve për çdo sezon kultivimi):

Domate (serrë): për luftimin e Vrugut (*Phytophthora infestans*), Hirit (*Oidium neolycopersici*), Leveillula Taurica me dozë 100 ml/dynym ose 500 ml/10000 m² LWA (max) ** dhe me 20-100 litra tretësirë spërkatëse/dynym . Spërkatje gjethore parambrojtëse. Nga dalja e gjethes së parë të vërtetë deri në vjelje (BBCH 11-89). Deri në dy (2) trajtime me interval prej 7 ditësh.

Kastravec (serrë), Kungull (serrë), Pjepër (serrë), Shalqi (serrë): për luftimin e Vrugut (*Pseudoperonospora cubensis*), Didimellës (*Didymella bryoniae*) me dozë 100 ml/dynym ose 500 ml/10000 m² LWA (max) ** dhe me 20-100 litra tretësirë spërkatëse/dynym . Spërkatje gjethore parambrojtëse. Nga dalja e gjethes së parë të vërtetë deri në vjelje (BBCH 11-89). Deri në dy (2) trajtime me interval prej 7 ditësh.

Marule (serrë): për luftimin e Vrugut (*Bremia sp.*), Kalbëzimit të bardhë (*Botrytis cinerea*) me dozë 100 ml/dynym dhe me 20-80 litra tretësirë spërkatëse/dynym . Spërkatje gjethore parambrojtëse.

Nga dalja e gjethes së parë të vërtetë derisa bima të arrijë madhësinë dhe formën e saj tipike (BBCH 11-49). Deri në dy (2) trajtime me interval prej 7 ditësh.

Vërejtje:

- Përdorimi në Marule përfshin Marule Kaçurrele, Marule Sallatë, Marule Kokë dhe Marule të Zakonshme.
- Përdorimi në Domate përfshin dhe Domatet Qershi (PHYGR).
- Në sistemet lineare (me rreshta) të mbjelljes së kulturave me rritje vertikale, për të përcaktuar dozën optimale në lidhje me fazën e zhvillimit të bimëve, llogaritni dozën për dynym duke marrë, parasysh përmasat e kulturës bujqësore (lartësinë e vegjetacionit dhe distancën midis rreshtave) dhe dozën LWA si më poshtë:

****Doza LWA: Doza përfundimtare për dynym** = $\frac{LWA}{100.000}$ x Doza LWA (për çdo kulturë bujqësore që jipet më lartë).

$$\text{Sipërfaqja gjethore (LWA)} = \frac{2 \times (\text{lartësia e vegjetacionit (metra)} \times 10.000)}{\text{distanca midis rreshtave (metra)}}$$

Për kulturat e perimeve në serrë:

Lartësia e bimësisë përcaktohet si distanca nga dalja e gjethes së parë të vërtetë deri në majën e bimësisë.

Doza LWA është fikse (500 ml për 10000 m² LWA), ndërsa doza përfundimtare e aplikuar për dynym rritet duke ndjekur madhësinë e sipërfaqes gjethore, me dozë maksimale të lejuar prej 100 ml për dynym.

Në mënyrë indikative, jipet **tabela e mëposhtme e dozave përfundimtare për dynym:**

	Lartësia e vegjetacionit (metra)								
		0,25	0,5	0,75	1	1,25	1,5	1,75	2
Distanca midis rreshtave (metra)	0,75	33	67	100	100	100	100	100	100
	1	25	50	75	100	100	100	100	100
	1,25	20	40	60	80	100	100	100	100
	1,5	17	33	50	67	83	100	100	100
	2	13	25	38	50	63	75	88	100

Trajtimi i fundit para vjeljes:

Domate (serrë), Domate qershi (serrë), Kastravec (serrë), Pjepër (serrë), Shalqi (serrë), Kungull (serrë): 3 ditë.

Marule (serrë), Marule Kaçurrele (serrë), Marule Sallatë (serrë), Marule Kokë (serrë), Marule të Zakonshme (serrë): 14 ditë.

Mënyra e përdorimit: Spërkatje gjethore.

Udhëzime për tërheqjen e sigurt të produktit dhe paketimit: Shishet bosh të ambalazhit shpëlahen me ujë nën presion ose shpëlahen tre herë (uji i shpëlarjes hidhet në rezervuarin e pompës spërkatëse) dhe pastaj pasi të jenë shkatërruar paraprakisht duke i shpuar, për të siguruar mos ripërdorimin, të vendosen në pikat e grumbullimit për riciklimin ose rikuperimin e energjisë.

Në përgjithësi **Përzihet** me shumicën e insekticideve, fungicideve dhe rregullatorëve të rritjes që përdoren në këto kultura bujqësore. Në rastin e përzierjes me produkte të tjera, bëni paraprakisht testin e pajtueshmërisë.

Menaxhimi i rezistencës: Për të shmangur zhvillimin e rezistencës, rekomandohet të ndiqni udhëzimet e mëposhtme dhe gjithçka që është më kufizuese në secilin rast:

- Përdorni ORONDIS EVO 25/1.2 SC në trajtime parambrojtëse
- Përdorni ORONDIS EVO 25/1.2 SC në alternim me preparate që përmbajnë lëndë aktive me rezistencë të kryqëzuar të ndryshme me efikasitet të lartë kundër

patogjenëve të njëjtë.

- Përdorni ORONDIS EVO 25/1.2 SC të alternuar me fungicide që nuk përmbajnë lëndë vepruese të grupeve 11 dhe 49 sipas FRAC.
- Spërkatjet me ORONDIS EVO 25/1.2 SC ose me çdo produkt që përmban lëndë vepruese të grupit 49 sipas FRAC nuk duhet të kalojnë 33% të spërkatjeve për çdo sezon kultivimi me numër maksimal trajtimesh 1 ose 2 (në varësi të kulturës bujqësore dhe tokës) për ORONDIS EVO dhe 4 në total me produkte që përmbajnë lëndëvepruese të grupit 49 sipas FRAC.
- Mos tejkaloni 1 spërkatje me ORONDIS EVO 25/1.2 SC (ose me ndonjë produkt tjetër që përmban lëndë vepruese të grupit 49 sipas FRAC) kur kërkohen më pak se 3 spërkatje në total për të luftuar oomicetet për çdo sezon kultivimi.
- Ndalohen spërkatjet gjethore me ORONDIS EVO 25/1.2 SC (ose çdo produkt tjetër që përmban lëndë vepruese të grupit 49 sipas FRAC) kur është përdorur për dezinfektimin e farërave ose trajtimin e tokës preparat që përmban lëndëvepruese që i përket grupit 49 sipas FRAC.
- Për luftimin e sëmundjeve në kulturën e domates në serë: kur përdorni fungicide që përmbajnë lëndë vepruesnjë të grupit 11 sipas FRAC (QoI) në përzjerje me lëndë veprues nga një grup tjetër, mos bëni më shumë se 50% të numrit total të spërkatjeve ose 6 trajtime me fungicide të grupit 11 (duke aplikuar më të paktën sipas rastit). Mos tejkaloni 3 trajtime të njëpasnjëshme me formulime që përmbajnë lëndë vepruese të grupit 11 sipas FRAC.
- Për luftimin e sëmundjeve në kulturat e kungulloreve dhe marules në serrë: përdorni maksimumi një trajtim me ORONDIS EVO (ose me çdo produkt tjetër që përmban lëndë vepruese të grupit 11 sipas FRAC) në 3 trajtimet me fungicide për sezon kultivimi. Përdorni maksimumi 3 trajtime me produkte që përmbajnë një përbërës aktiv të grupit 11 për çdo kulturë. Mos përdorni fungicide që përmbajnë lëndë vepruese të grupit 11 në mënyrë të njëpasnjëshme, vazhdoni alternimet edhe në kulturat pasuese.
- Mos e përdorni produktin në farishtet e prodhimit të fidanëve.

Intervali kohor i sigurisë midis trajtimit dhe futjes së njerëzve ose kafshëve në parcelën e trajtuar:

Mos hyni në zonën e spërkatur përpara se tretësira spërkatëse të jetë tharë në sipërfaqen e gjetheve.

Fitotoksiciteti: Nuk është fitotoksik kur përdoret në kulturat bujqësore dhe në dozat e rekomanduara. ORONDIS EVO 25/1.2 SC përmban lëndën vepruese azoxystrobin, e cila shkakton fitotoksicitet në disa varietete molle. Për këtë arsye, gjatë spërkatjes, duhet të tregohet kujdes që të shmangët përhapja e tretësirës spërkatëse në zonat ngjitur, të kultivuara me mollë. Mjetet spërkatëse që janë përdorur për trajtime me ORONDIS EVO 25/1.2 SC duhet të shpëlahen me kujdes të veçantë para se të përdoren tek molla.

Periudha dhe kushtet e ruajtjes:

Produkti mbetet i qëndrueshëm për 3 (tre) vjet, në paketimin e tij origjinal të mbyllur, në vende të thata, të freskëta dhe të ajrosura mirë, larg nga rrezet direkte të diellit.

Nr. dhe data e regjistrimit: 56, datë 26.05.2026

Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin baze: nga 100 ml deri 20 litra;

Data e prodhimit: ;

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkeseva të përcaktuara): 3 vjet;

Numri i partise së mallit (serise) ose shenja të tjera identifikuese ;

Tipi i ambalazhit baze: shishe plastike HDPE (High density polyethylene), HDPE/PA

Emri dhe adresa e kerkuesit: Syngenta Crop Protection AG. Adresa: Basel, Zvicer.

Emri dhe adresa e fabrikuesit të PMB-se: Syngenta Crop Protection AG. Adresa: Basel, Zvicer